



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

NJOFTIM

PËR SHPALLJEN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR PESË POZICIONE TË LIRA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 02.07.2020, ka vendosur:

- *rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjithsej për katër pozicione të lira;*
- *hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.*

Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për secilin nga katër pozicionet e lira, janë rihapur me Vendimet nr.220, nr.221, nr.222 dhe nr.223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë, është hapur me Vendimin nr.224, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me këto vendime Këshilli i Lartë Gjyqësor ka *shpallur kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në total për pesë pozicione të lira.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar që është në një pozicion të juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ, ose në një pozicion të komanduar, i cili plotëson kriteret ligjore të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të marrë pjesë në këto procedura ngritjeje në detyrë dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuara në vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të pasqyruar edhe më poshtë.

Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përcaktohen në pikën 3 të nenit 8, në shkronjën “b” të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:

- a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
- b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- c) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- ç) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Plotësimi i kriterëve të kandidimit do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur, duke e identifikuar atë përmes numrit të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopje të kartës së identitetit;
- ç) Vetëdeklarim/Vetëdeklarime për dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas kërkesave të Ligjit nr. 95/2016 “Për

organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

d) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi;

dh) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues, për secilin nga pozicionet e lira, është është tre javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen apo hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë. - Ky afat përfundon më datë 26.07.2020.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Bulevardi “Zog I”, Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimet e tij nr.220, nr.221, nr.222, nr.223 dhe nr.224, datë 02.07.2020.

Kujdes:

Në zbatim të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

- Në procedurat e ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë ose të specializuar mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret ligjore, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar në procedura të mëparshme ngritjeje në detyrë.
- Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës.
- Në rast të kandidimit në më shumë se tre pozicione të lira në proces, kandidati duhet të rikonsiderojë kandidimet e tij, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat vijon kandidimin. Mospërcaktimi i tyre nga vetë kandidati, passjell identifikimin e vullnetit të tij në bazë të kohës së kandidimeve, duke filluar nga ai i bërë më parë ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, në bazë të radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë.
- Kandidimi për një pozicion të lirë për të cilin procedura e ngritjes në detyrë është finalizuar/përmbyllur dhe kandidimi i tërhequr, nuk llogariten si kandidime për efekt të të drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira.

Ky njoftim është publikuar më datë 03.07.2020.